



Prishtinë, 30 mars 2011
Kodi i ZRRE-së: V_341_2011

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe 2.17, dhe Nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Dispozitat e Nenit 4 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes; dhe
- Kërkesën e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK Sh.A) për derogim (shtyrje afati) në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Shpërndarjes, të datës 08 shkurt 2011,

Në seancën e mbajtur me datë 30 mars 2011, nxori këtë:

VENDIM

- I. **I LEJOHET** Korporatës Energjetike të Kosovës derogimi në zbatimin e disa neneve dhe dispozitave të Kodit të Shpërndarjes si në Shtojcë të këtij vendimi .

Arsyetim

- Korporata Energjetike e Kosovës (KEK Sh.A), me datë 08 shkurt 2011 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) kërkesën për derogim të disa dispozitave të Kodit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
 - ZRRE ka analizuar dispozitat dhe arsyetimin e paraqitur në kërkesën e KEK-ut, dhe bazuar në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
- IV. Vendimit i bashkëngjitet Shtojca me dispozitat për të cilat është lejuar derogim.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërbëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar



Shtojcë – Tabela me dispozitat për të cilat është lejuar derogim

Kodi i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike			
Nr.	Dispozita	Derogimi i datës 30.03.2011 deri më:	Koment nga ZRRE
1.	4.6 Standardet e Dizajnit	31 dhjetor 2011	Kërkohet nga KEK sh.a të përmbush këtë dispozitë më së largu deri më 31 dhjetor 2011.
2	6-Operimi i Sistemit të Shpërndarjes Dispozita 6.1.4 Humbja e Qendrës së Kontrollit	31 dhjetor 2011	Kërkohet nga KEK sh.a të përmbush këtë dispozitë më së largu deri më 31 dhjetor 2011.